Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0786

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga; Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Kompania e Sigurimit Fizik Scorpion", kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të "Spitali i Përgjithshëm Gjilan" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objektit të Spitali Përgjithshëm Gjilan dhe objekteve tjera te cilat funksionojnë ne kuadër te Spitalit Përgjithshëm Gjilan" me numër të prokurimit 220-70001-0731-23-8886-2-1-1, me 26/01/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Kompania e Sigurimit Fizik Scorpion" me nr. 2023/0786, e datës 12/10/2023, kurse vendimi i AK "Spitali i Përgjithshëm Gjilan" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objektit të Spitali Përgjithshëm Gjilan dhe objekteve tjera te cilat funksionojnë ne kuadër te Spitalit Përgjithshëm Gjilan" me numër të prokurimit 220-70001-0731-23-8886-2-1-1anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "Kompania e Sigurimit Fizik Scorpion".

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 22.08.2023, "Spitali i Përgjithshëm Gjilan" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Sigurimi fizik i objektit të Spitali Përgjithshëm Gjilan dhe objekteve tjera te cilat funksionojnë ne kuadër te

Spitalit Përgjithshëm Gjilan". Ndërsa me datën 20.09.2023 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE "SAS shpk",

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 300,000.00 €

Me 25.09.2023, OE "Kompania e Sigurimit Fizik Scorpion" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 02.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 12/10/2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Kompania e Sigurimit Fizik Scorpion" me nr. 786/23 lidhur me aktivitetin "Sigurimi fizik i objektit të Spitali Përgjithshëm Gjilan dhe objekteve tjera te cilat funksionojnë ne kuadër te Spitalit Përgjithshëm Gjilan" me numër të prokurimit 220-70001-0731-23-8886-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues"Kompania e Sigurimit Fizik Scorpion" janë parashtruar si në vijim**:**

Pretendimet e Operatorit Ekonomik: **"***OE ankues ka dorëzuar një dokument voluminoz me analiza, pretendime jo shume të kjarta dhe shumë të përgjithësuara, megjithatë eksperti është munduar që të sqaroj këto pretendime sa me mire dhe ti elaboroj ato mbi gjendjet faktike duke u marre me pretendimet konkrete si ne vijim:Po ashtu, ky OE i shpallur fitues ka edhe disa mungesa në dokumentacione dhe disa dokument të dyshimta të kontestuar në vërtetësinë dhe validitetin e tyre sipas kërkesave ne DT tek Kapaciteti Teknik he Profesional , Pozicioni 9.189.2.*

1. Mungon Raporti i Vlerësimit të Riskut siç ka kërkuar AK ne DT tek kërkesa 7, pike b), Ne si OF, gjate kërkesës për qasje ne dokumente, nuk kemi pranuar ne email nga AK Raportin e Vlerësimit të Riskut.

2. Mungon Deklarate nga Kompania për Caktimin e Menaxherit siç ka kërkuar AK të kërkesa 6, Në ofertën e OE te rekomanduar nuk është prezantuar deklarata për caktimin e menaxherit të projektit siç kërkohet ne DT.

3. Tek kërkesa 8, pika b), është kërkuar lista e stafit me te cilën OE planifikon te mbulon kërkesat e DT-së, ndërsa OE ka paraqitur listën e stafit menaxherial të kompanisë dhe jo listën me të cilën planifikon te mbuloje pikat e reparteve.

4.spitalore, prandaj dhe kjo liste nuk përshtatet me kërkesën ne Dosjen e Tenderit, Lista e Kontratave/Referencave nuk është e qarte, sepse nuk kanë date të fillimit dhe mbarimit, pra nuk është dëshmuar që shërbimet janë të përfunduara siç kërkohet ne dosjen e tenderit dhe kontratat e sigurimit fizik nuk përputhen me Kompanitë e shënuara në listë, ku po ashtu kontratat e dorëzuara të sigurimit fizik nuk arrijnë vlerën e 600,000.00€, sepse OE i rekomanduar ka deklaruar kontrata të vëzhgimit elektronik dhe jo sigurim fizik siç është kërkuar nga AK dhe Qarkullim Financiar është kërkuar të jetë minimumi dyfishi i vlerës se parashikuar (300.000.00€), pra të jete 600.000.00€ dhe kontratat e sigurimit fizik nuk arrijnë shumen prej 600.000,00€ dhe kontratat e sigurimit fizik duhet të përputhen me vlerën e kërkuar të qarkullimit financiar.

5. ISO Standardet 9001:2015 dhe 45001:2018 janë jo-valide, sepse nuk verifikohen në websiten për verifikimin e validitetit apo vërtetësisë se certifikatave.

KURSE, AK me rastin e eliminimit te OE ankues u ka dhënë këtë shpjegim mbi të cilin ata nuk e kane plotësuar apo dorëzuar analizën financiare si dhe kalkulimet e pagave baze ne mënyrë të duhur siç është kërkuar me dosje të tenderit ku është dashtë të përdoret edhe kalkulatori zyrtar i ATK-së. ATK-së. Grup OE Besa Security dhe Scorpion 1. Nuk e keni plotësuar Analizën Financiare sipas dosjes se tenderit ku është kërkuar ne kërkuar që paga bruto e stafit të jete jo me e vogël se 350euro bruto ,kurse ju keni shtuar pagës bruto plus 17.50€si derivat i këtij është bere gabimisht llogaritja dhe elementet e tjera të pagës si dhe pushimet vjetore janë llogaritur gabimisht gjë e cila bënë ofertë: papërgjegjshme. Sepse paga e një punëtori duhet të vinë nga paga bruto ne pagën neto. (Shih shabllonin e ATK-se se si duhet të jetë bruto ne pagën neto, dhe nga paga neto ne pagën bruto https://www.atk-ks.org/kalkulatori-i-pagave-nga-neto-ne-bruto/) 2. Komisioni i vlerësimit. ka shpallur fitues OE SAS. Shpk i cili është me çmim me të lire dhe i cili ka dorëzuar analizën financiare kërkesave të AK-së të Specifikuar ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për Kontrate."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "Kompania e Sigurimit Fizik Scorpion"konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin **11, 7, 59, 60, 69, dhe 72** të LPP-së, si dhe neni **38, nr.01/2022, 99.2 dhe 20&32 nr.03/L-212** .

Përgjigjja e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim. "OE Kompania E Sigurimit Fizik Scorpion me seli në Ferizaj ka ushtuar kërkesë për Rishqyrtim ndaj AK-se Spitali Përgjithshëm Gjilan , në aktivitetin e prokurimit"Sigurimi fizik i objektit të Spitali Përgjithshëm Gjilan dhe objekteve tjera te cilat funksionojnë ne kuadër të Spitalit Përgjithshëm Gjilan " me nr. prokurim 220-700010731-23-8886-2-1-1.. Autoritet Kontraktues duke u bazuar në kërkesën për rishqyrtim të OE në falë ka Refuzuar si te pa bazuar sepse ne kërkesën për rishqyrtim ka dhënë pretendime të pa bazuar.Pretendimi i Grup OE tek kapaciteti teknik dhe profesional lidhur merregulloren për Prokurim Publik 001/2022 . Ju Si Grup OE ne këtë aktivitet të prokurimit nuk keni plotësuar nenin 70 të LPP-së dhe Rregulloren 001/2022 neni26.6 Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standard të caktuara për sigurimin ose cilësinë që bazohen në standard kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, se cili anëtar I grupit do të dëshmoi se I për mbush standardet përkatëse. Ne kërkesën tuaj për rishqyrtim keni cekur një pike tjetër e cila nuk

ka qene pjesë Letër Standardë ku kemi dhënë sqarim për këtë pike të bashkangjitur gjeni (screnshot) lidhur me këtë pretendim i cili është i pa bazuar dhe i pa vërtet nga ana juaj. Pretendimi lidhur me veprimtarin e operatori ekonomik , për autorizimin për një klient aktiv i Licencës se vëzhgimit elektronik OE ju si GRUP operatorëve ekonomik keni dorëzuar këtë dokument sikur se OE i rekomanduar për dhënje të kontratës edhe ky pretendimi i ngritur nga ana juaj nuk qëndron (ScrenShot) gjeni te bashkangjiturDokumentin nga partneri i këtij grupi Besa Security e cila është për "KompaninëEnernet Shpk" Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ka një autorizimin për një klient aktiv por të një kompania tjetër "Gëzimi Engnieering Shpk" , por i njëjti Operator Ekonomik ka Certifikatën me Validitet (SrenShot) gjeni te bashkangjitur dhe ky pretendim nuk qëndron se OE . Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës është i certifikuar dhe ka validitet deri ne vitin 2026.Pretendimi juaj se AK ka bere shkeljen Nenin 59 nuk qëndron është i pa bazuar sepse Autoriteti Kontraktues edhe gjate vlerësimi të ofertave është konsultuar me shume njohës të kësaj natyre dhe me personat përgjegjës se ATK-së.Pjesa 1 (analiza financiare jo konformë kërkesave të DT) Tek aneksi 1 i dosjes se tenderi ne kemi kërkuar si vijon" Paga mujore bruto 350.00€, ku pagës neto duhet të i shtohet kontributi i punëdhënësit 5 ^{0}/0, kontributi i punëtorit 5 % si dhe tatimi mbi paga. Si do te llogaritet TVSH 18 ^{0}/0 Sipas Analizës Financiare . OperatoretEkonomik qe do të sjellin Ofertën e tyre nen vlerën e parashikuar dhe sipas këtyre kritereve të dosjes se tenderit Oferta e tyre do te shpallet e papërgjegjshëm "Kurseju ne analizën tuaj pagës bruto keni llogaritur edhe pushimet vjetore duke u bazua ne ligjin e punës neni 32 nuk lejohen të kompensohen me para pushimet vjetore te punëtorëve.Ne analizën tuaj financiare ju nuk keni bere kalkulimin tuaj sipas specifikacionit të DT , ne si AK kemi kërkuar qe analiza juaj të përmbajë si vijon; Pagën neto I Kontributet e punëtorit II Kontributet e punëdhënësit , Tatimet III Dhe rrjedhimisht edhe TVSH-ja • PAGA NETO (sipas specifikacionit te DT) Ne asnjë variant tuajin të ofertës ju nuk keni paraqitur pagën neto Siç e kërkon dosja e tenderit dhe mbi të cilën do të duhej të aplikoheshin elementet tjera.Sqarim: As në kërkesën tonë për sqarimin e dosjes së tenderit ju nuk keni paraqitur fakte se cila është paga neto mi te cilën do te ngarkoheshin elementet tjera . Kontributi i punëtorit (sipas specifikacionit te DT) Ne asnjë variant tuajin të ofertës ju nuk keni paraqitur fakte se cili është Kontributin i punëtorit siç e kërkon dosja e tenderit.

Sqarim: As në kërkesën tonë për sqarimin e dosjes së tenderit ju nuk keni paraqitur fakte se cili është kontributi i punëtorit (apo të nr te punëtorëve në total) në ofertën tuaj sipas kërkesës në DT. • Tatimi ne page (sipas specifikacionit te DT) Në asnjë variant tuajin të ofertës ju nuk keni paraqitur tatimin ne page siç e kërkon dosja e tenderit.Sqarim: As në kërkesën tonë për sqarimin e dosjes se tenderit ju nuk keni paraqitur fakte se cila është tatimi në page në ofertën tuaj sipas kërkesës në DT.Pjesa 2 (impakti i analizës financiare konforme kërkesave të DT)Tek aneksi 1 i dosjes se tenderi ne kemi kërkuar si vijon" Paga mujore bruto 350.00€, ku pagës Neto duhet të i shtohet kontributi i punëdhënësit 5%, kontributi i punëtorit 5 % si dhe tatimi mbi paga. Si do te llogaritet TVSH 18% Sipas Analizës Financiare . Operatoret Ekonomik qe do te sjellin Ofertën e tyre nen vlerën e parashikuar dhe sipas këtyre kritereve te dosjes se tenderitOferta e tyre do te shpallet e papërgjegjshëm"Ju ne ofertën tuaj keni ofruar informata se pagës 350€, duhet shtuar edhe kontributet e punëdhënësit dhe rrjedhimisht paga ka kapur lartësinë 367.50 + 26.53

pushimeve vajtore ku paga bruto 394.03€ ku ne asnjë variant nuk keni treguar se sa është paga neto e punëtorëve nëse paga bruto e llogaritet nga ana juaj është 394.03 sa do te ishte paga neto e një punëtori, që rrjedhimisht ka bërë ofertën tuaj të papërgjegjshme për arsyet në vijim; 1.Paga mujore bruto , 2. Pushimet vjetore të punëtorëve. PAGA MUJORE BRUTO (sipas specifikacionit të DT të lartshënuar) ju bazën prej 350€ e keni ngritur mbi bazën e kontributeve të punëmarrësit dhe e keni ofruar 367.50+26.53=394.03€.gjë e cila nuk është kompatibile me kërkesën e DT të lartshënuar. Si argument për këtë qështje ne ju ofrojmë shablloni e ATK-së i cili është dokument zyrtar se çka definohet si pagë bruto https://ëë.atk-ks.org/_33184-2/ https://www.atk-ks.org/kalkulatori-i-pagave-nga-neto-nebruto/ Pushimet vjetore po ashtu në kërkesën e AK për ofrimin e informatave sqaruese ju nuk keni sqaruar se si janë kalkuluar pushimet vjetore (mbi bazën 367.50€ siç e keni trajtuar pagesën e punëtorëve apo 350€ siç ka qenë kërkese e DT) .Meqenëse ju keni marrë për bazë që paga e punëtorit është 367.50€, atëherë edhe kalkulimi i pushimeve do duhej të ishte mbi këtë bazë dhe jo mbi ndonjë bazë tjetër. Duke u bazuar neLigjin e Punës pushimet vjetore janë të kalkuluar ne pagën bruto dhe është gabimisht I llogaritur nga ana juaj sepse ju përveç Pagës bruto , keni llogarit shtesën për 17.50 po ashtu edhe pushimin vjetor I keni bashkangjitur pagës bruto , Neni 32 ligjit të punës saktësisht tregon se. I punësuari gjatë çdo viti kalendarik ka të drejtë për pushim vjetor të paguar në një kohëzgjatje prej së paku katër (4) javë, pavarësisht a punon me orar të plotë apo të shkurtuar. Ditët e pashfrytëzuara te pushimit vjetor nuk mund të kompensohen me para, përjashtimisht kjo mund të bëhet kur marrëdhënia e punës i skadon të punësuarit. Ku me këtë ju keni bërë keq llogaritjen dhe pagës bruto I keni shtuar plus edhe pushimin vjetor ku mbi ndesh me ligjin epunës. Nëse Paga Bruto e punëtori sipas analizës tuaj financiare është 394.03€ sipas Kalkulatorit te ATK-se paga neto e një punëtori është 357.58euro. Kurse ne sqarim tuaj të kërkesën se AK-se lidhur me Analizën Financiare ke thënë se paga e një punëtori është 319.1 euro . Gjatë analizimit te sqarimit tuaj lidhur me kërkesën e AK-se për Analizën Financiare ju ne sqarim tuaj nuk e keni fituar edhe pushimet vjetore pagës bruto kurse ne analizën tuaj e keni llogaritur gjeni të bashkangjitur sqarimin tuaj.Ne këtë sqarim tuaj nuk është llogaritur pushimi vjetor sepse është i ndaluar të llogaritet me ligj për këtë komisioni i vlerësimit ju ka shpallur të papërgjegjshëm sepse oferta juaj është me çmim me shtrenjtë përshkuaka këtij gabimi të llogaritu nga ana juaj qe ka bere ofertën me çmim me shtrenjte se sa e OE “SAS Shpk” , me poshtë gjeni te bashkangjitur shabllonin e ATK-se. Ku si dëshmi kësaj llogaritje sipas analizës tuaj financiare është dashur të llogaritet ne këtë mënyre Ndërsa Sqarimi juaj i datës 02.10.2023 është e kundërta e ofertës të cilën e keni dorëzuar se bashku me analizën tuaj Financiare me poshtë gjeni llogaritjen e cila është bere për të vërtetuar se Analiza juaj është ne kundërshtim me dosjen tenderit. Sepse ne asnjë pikë nuk është përmendur se pushimet vjetore të hyn ne pagën bruto sepse është ne kundërshtim meLigjin e punës neni 32 .Kjo tabelë është bere ne baze të analizës tuaj qe keni dhënë page bruto për punëtoret ku sipas kësaj del se kur te llogaritet Paga Neto 357.58+16.75+19.70=394.03€ Paga Bruto e një punëtori sipas kalkulatori te ATK-se është 394.03€, Paga Neto : 357.58 €. Kontributi i Punëdhënësit : 19.70 €, Tatimi ne page : 16.75€ , Gjithsej : 394.03€ Paga Bruto i një punëtori.Analiza juaj financiare dhe Sqarimi i juaj për analizën financiare është ne kundërshtim njëra me tjetrën dhe për këtë arsyeje jeni shpallur i papërgjegjshëm ne këtë aktivitet te prokurimit. Ne Analizën Financiare të dërguar nga ana juaj

në asnjë variant nuk është rillogaritur paga neto te bashkangjitur gjeni edhe analizën financiare.Nëse do të llogaritet Paga Neto e një punëtori 357.58x20punetori = 7,151.60€ paga neto për një muaj 7,151.60x36 = 257,457.60 x 1.18 = 303,799.968€ Paga neto për 36 muaj. Ofertat juaj sipas Analizës sonë është si ne vijmë Paga Neto 36 muaj = 257.457.60 €Uniforma për 20 punëtorët =800.00 € Fitimi i Kompanisë =590.94€ TVSH =46,342.36€ Gjithsej = 305,190.90€ . Nëse do te llogaritet Paga Bruto e një punëtori 394.03x20punetori = 7,880.6€ paga Bruto për një muaj 7,880.6x36 = 283,701.60 x 1.18 = 334,767.88€ Paga Bruto për 36 muaj .Ofertat juaj sipas Analizës sonë është si ne vijmë:Paga Bruto 36 muaj = 283.701.60 €, Uniforma për 20 punëtorë = 800.00 €, fitimi i kompanisë = 590.94€, TVSH 18%=51,066.28€, gjithsej = 336,158, 828€. Rekapitullimi sipas analizës tuaj financiare: Paga bruto : 7,880.60x36=283,701.60€, gjithsej kontributi i punëdhënësit : 394.00x36=14,184.00€, Gjithsej kontributi I punëtorit :394.00x36=14,184.00€, tatimi burim:335x36=12,060€, Uniforma : 800.00€, Fitimi i kompanisë : 590.94€, Totali TVSH :51,316.66€, Gjithsej totali:362,653.80€.Llogaritja e Analizës financiare është bere sipas analizës tuaj të dorëzuar sipas pagës bruto ,por ju kemi jep ne detaje sepse analiza juaj nuk është bere ne harmoni me dosjen e tenderit , ne këtë llogaritje nuk është hyr kontributi I punëtorit sepse atë vete punëtori e paguan këtu është hyre vetëm kontributi I punëdhënësit. Por ne këtë rekapitullim është dhënë si shume qe rrjedhe nga kontributi I punëtorit ne fund të fundit autoriteti kontraktues do të paguan faturën ne baze të çmimit për njësi ORE pune .Rekapitulimi Sipas Analizës tuaj Financiare :Paga Neto:7.151.60x36—257,457.60€; Gjithsej kontributi i punëdhënësit :394.00x36=14,184.00€; gjithsej kontributi i punëtorit:394.00x36=14,184.00€; Tatimi burim: 335x36=12,060€; Uniforma:800.00€; Fitimi i kompanisë: 590.94€; Totali TVSH: 45,342.36€; Gjithsej Totali:331,434.90€.

Edhe ne këtë rekaptulim të pagës neto nuk është hyri njeri kontribut dhe del vlera totalë 331,434.90€ ku me shume kujdes kemi sqaruar të gjitha dhe ne përfundim është ardhur se analiza juaj nuk është dorëzuar konform dosjes se tenderit dhe sipas analizës tuaj kemi bere llogaritjen e pagës Bruto dhe Pagës ne dy variantet oferta juaj është me çmim me larte se sa oferta e operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës. Autoriteti Kontraktues me shume kujdes ka analizuar dhe ka ardhur ne përfundim se analiza juaj nuk është dorëzuar konform dosjes se tenderit duke u bazuar edhe ne shabllonin e ATK-së . https://www.atk-ks.org/kalkulatori-i-pagave-nga-neto-ne-bruto/ Pretendimi i juaj lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional nuk qëndron se

Operatori ekonomik ka vlerësimin e riskut dhe të bashkangjitur si prova do te keni edhe vlerësimin e riskut nga OE“SAS SHPK” ku ne E prokurim gjate ngritjes se këtij vendimi do të këtë edhe riskun i cili është ngarkuar ne E-prokurim nga OE . Gjate dërgimi të dokumenteve pas kërkese për qasje ne dokument nga numri i madhe i dokumenteve ka pasur mundësi të mos pranohet nga email. Pretendimi juaj lidhur me listën e stafit të cilët do te mbulon te gjitha pika, seoperatori ekonomik fitues është i obliguar të mban të gjithë punëtoret të cilat janë duke punuar aktualisht dhe deklarata e Operatori Ekonomik si do ti punësoi 20 punëtor është mjaftueshëm dhe operatori ekonomik ka sjellur një listën të punëtoreve të cilat ka të angazhuar ne kompaninë tij. Po ashtu Operatori Ekonomik ka dorëzuar edhe listën e punëtorëve sipas kërkesës se dosjes se

tenderit duke llogaritur pagën bruto dhe pagën neto të punëtoreve për 20 punëtorë siç është kërkuar na dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrate edhe këtë dëshmi juaj përcjellim me (srenshot) ku OE e ka dorëzuar ne Eprokurimi se bashku me ofertën por disa nga dokumentet nuk janë pranuar përmes email por do ti keni të bashkangjitura si fakte gjate ngarkimit të këtij vendimi. Ky pretendim nga ana juaj nuk qëndron është i pa bazuar. Operatori Ekonomik ka te bashkangjitur listën e kontratave dhe kjartë tregon se ka qarkullim mbi 600, 000.00 ne tri vitet e fundit ne listën e kontratave dhe qarkullimin bankar tregon se OE ka përmbushur këtë kriter dhe ky pretendim nga ana juaj nuk qëndron. Listave te kontratës do ti bashka ngjitemi si fakte përmes E prokurimit , Kontrata dhe Referencat e Operatorit Ekonomik ku ka përmbush kriterin e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate. Pretendimi juaj lidhur me Certifikatat ISO te cilat nuk janë valide nuk qëndron sepse operatori ekonomik ka sjellur me validitet të gjitha Certifikatat të cilat janë kërkuar për këtë aktivitet të prokurimit ne (Screnshot) do të juaj bashkangjitemi të gjitha ISO . Duke u bazuar ne kërkesën tuaj për rishqyrtim të Vendimit lidhur me përshkrimin çmimit , me poshtë kemi dhënë sqarimin lidhur me pretendimin tuaj përshkrimin me poshtë kemi jep ne detaj sqarim lidhur me këtë pretendim. Pretendimi se oferta është dhënë me shume shifra pas prese dhjetore. Tek faqe 2 i DT respektivisht pjesa 5. Lloji Kontratës, Kërkesat dhe Kushtet e dërgesës, Kushtet e Kontratës. DT përcakton se 5.1 Lloji i kontratës Publike kornizë — Çmimi për njësi. Thelbi i kontratës është çmimi për njësi dhe bazuar në këtë kërkese OE i rekomanduar për kontratë ka dhënë çmimin për njësi konformë kërkesës të shënuar në DT (respektivisht çmimi i dhënë nga operatori është 2.62€ me TVSH , pra është me dy shifra pas presës dhjetore).

Edhe në formularin e dorëzimit të çmimit çmimi i dhënë nga operatori është 2.62 me TVSH € për ore sipas Analizës Financiare të dorëzuar nga Operatori Ekonomik, dhe nuk ka asnjë dyshim se nuk është konformë kritereve të DT dhe këtë fakt e ka konstatuar edhe komisioni i vlerësimit në mënyrë të drejtë. Sepse thelbi i kësaj kontrate është çmimi për njësi , kurse operatori ekonomik ka dhënë çmimin për njësi me harmoni me ligjin.Autoriteti Kontraktues ka përgatitur përshkrimin e çmimit format jo të standardizuar të krijuar nga sistemi E-prokurim por ka punuar ne formën exel dhe ne baze të kësaj komisioni i vlerësimit ka vlerësuar ne mënyrë të drejt. Analiza Financiare e Operatorit Ekonomik I rekomanduar për dhenje të kontratës është në harmoni me dosjen e tenderit ku është kërkuar Paga bruto e punëtorit. Operatori Ekonomik ka dorëzuar Analizën Financiare dhe pagat bruto dhe neto i kallogaritur sipas Shabllonit te ATK-se , me poshtë gjeni të bashkangjitur Analizën financiare të operatorit ekonomik.Operatori Ekonomik "SAS Shpk" ka dorëzuar analizën financiare sipas kërkesave të dosjes se tenderit ANEKS 1 - Operatori Ekonomik ka dhënë çmimin për ore 2.62 dhe thelbi i kësaj kontrate është çmimi për ore dhe operatori ekonomik do të paguhet për ore. Sipas përshkrimit të çmimit ne Exel të dorëzuara nga Operatoret Ekonomik. Operatori Ekonomik ne Rekapulimin nuk është llogaritur kontributi i punëtorit 5 % ne vlere totale prej 12,637.03€ dhe ne baze kësaj pretendimi juaj është i pa bazuar dhe nuk ka tejkalim të ofertës dhe pretendimi juaj është i pa bazuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 01/11/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe

pretendimeve sipas ankesës me nr. 786/23, ndërsa me datë 09/11/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0786 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet Vendimi i AK për kualifikimin e Operatorëve Ekonomik dhe rekomandon që lënda të kthehet në rishqyrtim, duke konsideruar dhe propozuar qe gjate rivlerësimit të kërkohen sqarime shtese me detaje lidhur me këto pretendime te operatoreve ekonomik.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, "Autoriteti kontraktues nuk pajtohet me raportin e ekspertizës . Ndërsa OE Pajtohet nuk ka dhen përgjigje "

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "Kompania e Sigurimit Fizik Scorpion" eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 202/0786 ka vlerësuar si në vijim:

-Konstatimi (I) i ekspertit shqyrtues "*Përgjigje ne pretendimin ankimor nr.1: Operatori ekonomik ankues pretendon se OE i propozuar për kontrate i mungon:Mungon Raporti i Vlerësimit të Riskut siç ka kërkuar AK në DT tek kërkesa 7, pika b),Përgjigje: Gjate ekzaminimit te dokumentacionit eksperti verën se ky pretendim është i* ***bazuar*** *ngase ne dokumentacionin e dorëzuar me rastin e aplikimit për këtë procedure prokurimi një Raport i tille nuk ekziston përveç se ne fajllin nr.8 i emërtuar Raporti i autoritarëve dhe vlerësimi i riskut përveç raportit të auditorit, vlerësimi i riskut nuk gjendet aty."*

- Konstatimi (II) i ekspertit shqyrtues "*Mungon Deklaratë nga Kompania për Caktimin e Menaxherit siç ka kërkuar AK tek kërkesa 6, - Në ofertën e OE të rekomanduar nuk është prezantuar deklarata për caktimin e menaxherit të projektit siç kërkohet në DT. Përgjigje: Ne dokumentacionin e dërguar ne momentin e aplikimit për këtë procedure prokurimi eksperti verën se tek fajlli me nr.17 i emëruar Menaxheri i projektit brenda saj nuk ka vendim me të cilin OE ka caktuar menaxherin e projektit përpos qe ka ngarkuar diplomat dhe certifikatat e punëtorit ne fjalë (Meral Sadriu Vokshi). Andaj edhe ky pretendim i OE ankues* ***është i bazuar*** *duke konsideruar faktet dhe dokumentacionin e dorëzuar të cilën eksperti e ka pasur ne dispozicion.*

- Konstatimi (III) i ekspertit shqyrtues *"Tek kërkesa 8, pika b), është kërkuar lista e stafit me të cilën OE planifikon të mbulon kërkesat e DT-së, ndërsa OE ka paraqitur Listën e stafit menaxherial të Kompanisë dhe jo listën me të cilën planifikon të mbulojë pikat e reparteve.* ***Përgjigje:*** *Pas shqyrtimit te pretendimit dhe dokumenteve me kujdes, eksperti konsideron qe ky pretendim* ***nuk është i bazuar*** *dhe se OE "SAS" shpk ka dërguar mjaftueshëm dhe ashtu siç është kërkuar dokumentacionin e stafit dhe përshkrimet e vendeve të punës të cilët do të punojnë ne këtë projekt si dhe certifikatat e sistemit te menaxhimit të sigurisë. Andaj ky pretendim ankimor nr.3 nuk është i bazuar."*

-Konstatimi (IV) i ekspertit shqyrtues *"Lista e Kontratave/Referencave nuk është e qartë, sepse nuk kanë datë të fillimit dhe mbarimit, pra nuk është dëshmuar që shërbimet janë të përfunduara siç kërkohet në dosjen e tenderit dhe Kontratat e Sigurimit Fizik nuk përputhen me Kompanitë e shënuara në listë, ku po ashtu kontratat e dorëzuara të sigurimit fizik nuk arrijnë vlerën e 600,000.00€, sepse OE i rekomanduar ka deklaruar kontrata të vëzhgimit elektronik dhe jo sigurim fizik siç është kërkuar nga AK dhe Qarkullimi Financiar është kërkuar të jetë minimumi dyfishi i vlerës së parashikuar(300.000.00€), pra të jetë 600.000.00€ dhe kontratat e sigurimit fizik nuk arrijnë shumën prej 600.000,00€ dhe kontratat e sigurimit fizik duhet të përputhen me vlerën e kërkuar të Qarkullimit financiarPërgjigje: Tek ky pretendim konsiderojmë qe OE ankues ka dalur nga përmbajtja e kërkesës se Dosjes se tenderit. Duke sqaruar se ne DT nuk janë kërkuar kontrata dyfish por qarkullim financiar dyfishi i vlerës se parashikuar të kësaj procedure prokurimi. Andaj, gjate shqyrtimit te transaksioneve bankare del që të dy Operatoret e plotësojnë këtë kërkesë të DT. Duke konsideruar një vërejtje të vogël tek OE i propozuar për kontrate që ne vend të dërgimit të komplet transaksioneve kreditore dhe debitore të bankave do të kishte qene me mire ta marre një deklarate zyrtare nga banka të vulosur në të cilën shkruhet qarkullimi total i këtyre 3 viteve të fundit ashtu siç ka bere OE ankues qe për shkaqe ruajtje privatësisë kemi mbuluar shumat financiare. Andaj ky pretendim sipas eksperti* ***nuk është i bazuar*** *ne faktet e lartpërmendura."*

-Konstatimi (V) i ekspertit shqyrtues *" ISO Standardet 9001:2015 dhe 45001:2018 janë jo-valide, sepse nuk verifikohen në websiten për verifikimin e validitetit apo vërtetësisë së certifikatave.Përgjigje 5: Këtu eksperti konsideron qe çdo gjë është e qarte dhe qe ky pretendim ankimor* ***është i pabazuar*** *ngase faktet dhe dokumentacionin tregon qe OE ka dërguar ne dosjen e tyre certifikatat ISO të kërkuara me DT të cilat janë të vulosura dhe kane një datë lëshimi dhe datë skadence e po ashtu edhe ne ankesën e OE ankues theksohet se pas rishikimit edhe ata kane vërtetuar se janë shfaqur këto certifikata ne platformën online. Kurse sa i përketë pretendimit me të cilin është eliminuar OE ankues Scorpion dhe Besa Security eksperti ka analizuar këtë pretendim dhe japim sqarimet si ne vijim: OE pretendon ne ankesën e tij. Citojmë pjesë nga ankesa : Konstatimet e AK-së se ne jemi gabim tek kontributi i punëdhesit shtesë, janë të paqëndrueshme dhe të gabuara sepse siç e shihni më lart, AK ka kërkuar në DT të llogariten Pagat bruto 350€ për punëtorë me të gjitha kontributet dhe tatimet duke përfshirë edhe TVSH, andaj për të sqaruar detajisht, llogaritjet i fillojmë nga paga neto e pagës 350€ bruto sipas kalkulatorit të ATK-së dhe këtë llogaritje kemi sqaruar edhe në sqarimin tonë të datës*

19.09.2023 të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues: 1. Paga Neto = 319.10€ 2. Kontributin e Punëtorit 5% =17.50€ 3. Tatimi mbi Paga =13.40€ = 350€ Bruto Pastaj mbi pagën Bruto llogaritet vlera e Kontributit të Punëdhënësit 5% =17.50€ dhe Gjithsej Paga Për Punëtorë Është 367.50€. - Mund ti referoheni edhe kalkulatorit të ATK-së : https://www.atk-ks.org/33184-2/ Pra, kërkesa e AK-së në DT ka qenë e qartë se duhet të llogaritet paga bruto 350€ me të gjitha kontributet dhe ajo vlerë prej 17.50€ e Kontributit të Punëdhënësit është shtesë nga paga bruto siç dihet edhe ligjërisht dhe eliminimi jonë në lidhje me këtë pikë , ka kuptimin që AK mohon pagesën e kontributit të punëdhënësit 5% ku përbën shkelje të rendë të ligjeve të përcaktuara nga Administrata Tatimore e Kosovës."

-Konstatimi (VI) i ekspertit shqyrtues ***"****Përgjigje Se pari te shohim kërkesën e dosjes se tenderit e cila thotë qe: Paga mujore Bruto 350.00€, ku pagës Neto duhet të i shtohet kontributi i punëdhënësit 5%, kontributi i punëtorit 5 % si dhe tatimi mbi pagaPra, OE ankues siç duket i ka ikur ky detaj ne brendi të teksti ku thotë Pagës Neto duhet ti shtohet kontributi dhe tatimi mbi paga dhe jo PAGES BRUTO ashtu siç edhe e ka dorëzuar ofertën financiare dhe analizën OE ankues "Scorpion". Nga këndvështrimi ekonomik dhe financiar mbi e cilin edhe eksperti i përket kësaj fushe me këtë rast AK ka pasur te drejte ngase OE ankues është deshtë qe llogaritjen ta beje nga paga baze neto dhe duke shtuar tatimet dhe kontributet te arrij tek paga minimale bruto e kërkuar e cila ka qene 350 euro dhe jo te niset nga 350 e pastaj te shtoj kalkulimet tjera ku edhe me këtë rast paga e një punëtori i ka dalur 394.03 euro edhe pse është e drejte e çdo operatori ta cakton pagën maksimale të punëtorëve por ne këtë rast është dashtë që llogaritja të niset nga paga neto. Pra, shihet qe PAGA NETO e cila ka qene si kërkesë baze për nismën e llogaritjes se pagës minimale bruto nuk figuron askund ne analizën financiare të dërguar nga OE ankues. Andaj edhe ne këtë pretendim eksperti konsideron që AK ka vlerësuar drejte këtë pikë të kërkesës se DT dhe ky pretendim ankimor i OE ankues konsiderohet* ***si jo i bazuar****."*

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Kompania e Sigurimit Fizik Scorpion" Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së Tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit"Sigurimi fizik i objektit te Spitali Përgjithshëm Gjilan dhe objekteve tjera te cilat funksionojnë ne kuadër te Spitalit Përgjithshëm Gjilan" me numër të prokurimit: "220-70001-0731-23-8886-2-1-1".

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha

ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se AK nuk vepruar konform dispozitave të cituara si më sipër, të precizuara dhe të argumentuara ato në ankesë dhe në raportin e ekspertit shqyrtues. Në ketë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Raporti i ekspertit shqyrtues nuk prodhon efekte detyruese për asnjërën nga palët dhe as për panelin shqyrtues, prandaj i njëjti (natyrisht dhe vlerat provuese të tij) gjithnjë analizohen në raport me të gjitha shkresat e një lënde, me rrjedhën e procesit të prokurimit, veprimet e palëve, qëllimin dhe natyrën e një aktivitetit të prokurimit, i cili në parim synon përmbushjen e nevojave publike, me përdorimin e fondeve publike, të cilat i janë besuar secilit AK, në cilin do nivel.

Andaj, paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij për pretendimin 1, 3, 4 dhe 5 janë të pranueshme nga ana e këtij paneli. Ndërsa, lidhur me pohimin ankimor 2 të radhitur në raportin e ekpertizës sa i përket çështjes se mungon edhe deklarata e kompanisë për caktimin e menaxherit siç ka kërkuar AK tek kërkesa numër 6, ky faktë është i qëndrueshëm se i njëjti nuk është i caktuar me vendim, por OE i rekomanduar, ka caktuar menaxherin e projektit për këtë aktivitet të prokurimit përmes kontratës dhe kjo konktratë është e bashkangjitur në ofertë dhe në te janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësit e tij/saj. Si rrjedhoj, për panelin shqyrtues ky mund të merret si devijim i vogël nga ana e AK konform nenit 59.4 të LPP dhe në kuptim të nenin 6 të LPP.
Paneli Shqyrtues gjatë administrimit dhe vlerësimit të provave thekson se AK gjatë vlerësimit të këtij aktivitetit të prokurimit të veproj ne bazë nenit 59 të LPP, duke pas parasysh kërkesën numër 7 pika b të dosjes së tenderit ku mungon raporti i vlerësimit të riskut siç është kërkuar nga AK, rrjedhimisht duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat paneli shqyrtues konstaton se ky aktivitet i prokurimit duhet të kthehet ne rivlerësim dhe gjatë rivlerësimit AK te veproj ne bazë të dispozitave të LPP-së si dhe të kërkoj sqarime shtesë të detajuar konform nenit 72 të LPP lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik.
Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

- Përfundim –

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59, 60 të LPP, vetëm sa i përket pretendimit 1 të cituar në ankesë, ndërsa pretendimet 2, 3, 4 dhe 5 janë të pabazuara.. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN**
- OE - **Kompania E Sigurimit Fizik Scorpion**
- Arkivës së OSHP-së: